



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 425/5 prot.

Tiranë, më 25.11.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Pëllumb Zaimi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 10.11.2022, është njoftuar vendimi nr. 574, datë 18.10.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Pëllumb Zaimi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.
3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar

si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

3.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin z. Pëllumb Zaimi*”<sup>1</sup>, ka referuar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, fillimisht me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit<sup>2</sup>, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit*”. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, DSIK ka dërguar një raport të dytë të përditësuar,<sup>3</sup> ku referon se gjatë periudhës në të cilën z. Zaimi ushtronte detyrën si gjyqtar, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

3.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale<sup>4</sup>.

**4.** Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

4.2 *Për kontrollin e figurës.* Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

**5. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat [...].*

## II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri

<sup>1</sup> Raporti me nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2019, i ILDKPKI-së.

<sup>2</sup> Raporti nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, pa përfshirë përgjigjen e SHISH-it.

<sup>3</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*.5.2022.

<sup>4</sup> Raporti me nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2019, “Për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi”.

Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 574/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisioneri Publik ndaj vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III. A. Lidhur me etikën dhe profesionalizmin**

##### **III. A/1 Etika**

12. Nga aktet në dosje, konstatojmë se nga çështjet gjyqësore të analizuar për shkak të denoncimeve të paraqitura në Komision, ndër të tjera, janë evidentuar rrethana në të cilat duket se subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, konkretisht:

12.1 **Denoncim<sup>5</sup> i shtetasit \*\*\*.\*\*\*.** Ky shtetas, ndër të tjera, ka pretenduar për vendimmarrje të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin gjyqësor për konflikt pronësie, sipas tij, për pasurinë që ai trashëgon ndër vite. Ai e lidh vendimmarrjen edhe me pozitën e vajzës së subjektit, si drejtuese e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Berat, për shkak se, sipas tij, çështja konflikt gjyqësor ka si *person të tretë* edhe këtë institucion, i cili, sipas padisë, kërkohet që, ndër të tjera, të bëjë edhe regjistrimin e një sipërfaqe tokë.

12.2 **Denoncim<sup>6</sup> i shtetasit \*\*\*.\*\*\*.** Ky shtetas, i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, ndër të tjera, në ankimin e tij drejtuar Komisionit, por edhe instancave të tjera,<sup>7</sup> kërkon të pasqyrojë faktin se ankesa e tij është e ripërsëritur në drejtim të kërimit për përjashtim të subjektit të rivlerësimit nga zhvillimi i procesi gjyqësor të iniciuar prej tij me cilësinë e

<sup>5</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*8.2022.

<sup>6</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*5.2021.

<sup>7</sup> Komisioni ka administruar vendimin e ILD-së nr.\*\*\* prot., datë \*\*.2.2022, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga z. \*\*\*.\*\*\*", në të cilin nuk gjendet i arsyetuar pretendimi i këtij shtetasi mbi ekzistencën e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me ASHK-në.

paditësit, me *palë të paditur* Bashkia Berat, ASHK Berat dhe shoqëria ndërtimore “\*\*\*” sh.p.k., me *objekt*: “Pushim cenim pronësie dhe kallëzim i një punimi të ri”. Denoncuesi pretendon për gjendje të konfliktit të interesit në këtë çështje pronësore, me subjektin e rivlerësimit për shkak se praktika e ASHK-së Berat në adresë të tij është nënshkruar nga vajza e subjektit, si titullare e këtij institucioni. Në këtë kontekst, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga çështja objekt gjykimi. Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe për shkelje të etikës nga subjekti, duke sqaruar se është refuzuar mbajtja e seancave në audio.

12.3 Komisioni, për shkak të pretendimit në denoncime, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.9.2022, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, informacion mbi numrin e çështjeve të gjykuara nga subjekti me palë ndërgjyqëse ose person i tretë ASHK/Drejtoria Vendore Berat, prej periudhës shkurt 2021 e deri aktualisht, kohë në të cilën ka ushtruar dhe ushtron detyrën e drejtueses së kësaj të fundit, vajza e subjektit të rivlerësimit, \*\*\*.\*\*\*.<sup>8</sup>

12.4 Gjykata Rrethit Gjyqësor, Berat, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.9.2022, ka konfirmuar se: [...] nga verifikimi i sistemit ICMIS dhe regjistrave në kryesekretari rezulton se subjekti i rivlerësimit, për periudhën nga data 16.12.2021, deri në ditën e raportimit, ka gjykuar (përfunduar) gjithsej 12 çështje civile, ku palë ndërgjyqëse apo person i tretë ka qenë ASHK, Drejtoria Vendore Berat [...].

12.5 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>9</sup>, lidhur me këtë çështje, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe i ka kërkuar shpjegime mbi: [...] *arsyet e kohëzgjatjes së gjykimit, si dhe të depozitoni dokumentacion provues, pasi duket se keni vepruar në kundërshtim me pikën 5, shkronjën “e” të Aneksit nr.1 të Vendimit të ish-KLD-së nr. 261/2 datë 14.4.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve [...], si dhe [...] duket se gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore me palë pjesëmarrëse në proces ka qenë ASHK, drejtuese e së cilës është vajza e subjektit, e për rrjedhojë, duket se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të bërë në dispozitat përkatëse të kreut V të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 9367/2005, si dhe në mospërputhje me nenet 3/4, 4/2, e në vijim, të ligjit nr.96/2016 [...].*

12.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, pasi ka analizuar në mënyrë analitike çdo vendim, është shprehur<sup>10</sup> se çështjet janë regjistruar në gjykatë, gjatë kohës që vajza e tij nuk ka qenë drejtuese e ASHK-së, si dhe, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Nga shpjegimet e mësipërme, rezulton se ASHK DV Berat, në të 12 rastet e vendimeve të mësipërme, ka qenë në pozitën procedurale “person i tretë” dhe në të gjitha rastet nuk ka marrë pjesë në gjykim. Nga këto 12 vendime, në 2 raste, gjykata ka vendosur pranimin e padisë, në 2 raste ka vendosur rrëzimin e padisë, në 4 raste ka vendosur pushimin e gjykimit dhe në 4 rastet e tjera ka vendosur kthimin e kërkesë padisë dhe të akteve, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetence. Në të gjitha rastet e mësipërme, personi i tretë, ASHK DV Berat, nuk ka pasur ndonjë rol në gjykim dhe asnjë interes të ligjshëm [...].*

12.7 Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me konfliktin e interesit, arrin në përfundimin<sup>11</sup> se: [...] *Më konkretisht, duket të mos ketë rrethana konkrete apo arsye serioze njëanshmërie si një kërkesë e vetme që mbetet në zbatimin e nenit 72 të këtij Kodi, në këto raste gjykimi, pasi kërkesat e tjera duket të jenë të përjashtuara apo edhe për sa kohë duket të mos ketë shkaqe të arsyeshme për t’u vlerësuar me ndërgjegje nga subjekti, për sa kohë konfirmohet pozita e institucionit të ASHK-së/Drejtoria Vendore Berat në këto procese, roli dhe pasojat e tij. Gjithashtu, edhe referuar ligjit nr.96/2016 apo edhe ligjit nr. 9367/2005,*

<sup>8</sup> Referuar urdhrin nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të administruar në dosje të Komisionit.

<sup>9</sup> Shihni f. 51, të dokumentit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

<sup>10</sup> Shihni f. 43-55, të dokumentit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit.*

<sup>11</sup> Shihni f. 49, të vendimit.

*duket se konflikti i interesit, në raport me pozitën e palës ndërgjyqëse në proces, mbetet në nivel të parëndësishëm [...].*

12.8 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti dhe ka arsyetuar Komisioni mbi pozitën procedurale të personit të tretë, ASHK, *që mbetet në një nivel të parëndësishëm, së pari*, vlerëson se të drejtat procedurale të personit të tretë janë të njëjta me ato të palëve në proces, përveç atyre të drejtave që përbëjnë disponim të objektit të padisë<sup>12</sup>, dhe, *së dyti*, arsyet e njëanshmërisë nuk lidhen me rolin dhe pasojat e palëve ndërgjyqëse në proces, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, që të justifikojë qenien e gjyqtarit në vendimmarrje, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit.<sup>13</sup>

12.9 Po ashtu, pretendimi i subjektit se çështjet janë regjistruar në gjykatë para se vajza e subjektit, znj. \*\*\*.\*\*\*, të emërohej në detyrë, duket një argument i pabazuar, jo vetëm në drejtim të garantimit të paanësisë së trupit gjykues, që do të gjykonin çështjet e kësaj natyre, por edhe të garantimit të perceptimit të publikut, se drejtësia jo vetëm po jepej, por edhe të dukej se po jepej. Subjekti kishte detyrimin të tregonte një vëmendje të shtuar në drejtim të trajtimit me objektivitet të gjitha situatave të mundshme të konfliktit të interesit, edhe atij në dukje, për shkak të funksioneve drejtuese të znj. \*\*\*.\*\*\*, në institucionit e ASHK-së, Drejtoria Vendore Berat.

12.10 Në këtë vlerësim, Komisioneri Publik mban në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit,<sup>14</sup> si dhe konceptin e paanësisë sipas Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, ku paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Ajo gjen zbatim jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në procesin që e paraprin atë. Perceptimi i mungesës së paanësisë cenon besimin e publikut të drejtësia<sup>15</sup>.

12.11 Në përfundim, Komisioneri Publik vëren se, rastet e evidentuara më lart, pasqyrojnë mungesën e kujdesit të pritshëm të subjektit të rivlerësimit, për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, qoftë dhe në dukje, në vlerësim të zbatimit të pikës 6, të nenit 72, të Kodit të procedurës Civile, e cila parashikon rastin se gjyqtari detyrohet të dorëhiqet në rast se ekzistojnë arsye serioze njëanshmërie.

12.12 Në këto rrethana, Komisioneri Publik arrin në përfundimin se këto situata duhen trajtuar e konsideruar brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016, duke u vlerësuar në tërësi, në mënyrë kumulative, me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kritereve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

### **13. Aksione në shoqërinë “\*\*\*” sh.a.**

13.1 Në DV-2008, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. \*\*\*.\*\*\*, deklaron: *Pakësime: Bonot e privatizimit të punonjësës \*\*\*.\*\*\* u dorëzuan në degën e Thesarit Skrapar, si aksioner. Vlera: 50.000 bono privatizimi të vitit 1994. Pakësime: Bonot e privatizimit të jopunonjësit (\*\*\*) Pëllumb Zaimi u dorëzuan në degën e Thesarit Skrapar, për t'u bërë aksioner. Vlera: 75.000 bono privatizimi të vitit 1994.*

<sup>12</sup> Kodi i Procedurës Civile, neni 195.

<sup>13</sup> Referohuni dhe arsyetimit të Kolegjit në vendimin (JR) nr.16/2019, prg. 30.2.

<sup>14</sup> Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr.15/2021; si dhe vendimit (JR) nr. 31/2022.

<sup>15</sup>[https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry\\_on\\_the\\_Bangalore\\_principles\\_of\\_Judicial\\_Conduct.pdf](https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf). Testi i zbatuar rregullisht është nëse një vëzhgues i arsyeshëm, i cili e sheh çështjen në mënyrë reale dhe praktike, do të (ose “mund të”) perceptonte një mungesë paanësie nga gjyqtari, qoftë dhe për shkak të konfliktit të interesit. Gjyqtari duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një çështje, në të cilën një vëzhguesi të arsyeshëm mund t'i duket se gjyqtari e ka të pamundur të vendosë me paanësi.

13.2 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, znj. \*\*\*.\*\*\*, nuk kanë deklaruar zotërimin e këtyre aksioneve.

13.3 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni mbi deklarimin dhe statusin aktual të këtij veprimi, shprehet se: *[..] Në datën \*\*.1.2008 kam dorëzuar bonot e mia të privatizimit në shumën 75.000 lekë, në Degën e Thesarit Skrapar, për blerje aksionesh në \*\*\* sh.a., për shkak se bashkëshortja ime, \*\*\*.\*\*\*, ka qenë punonjëse e \*\*\* sh.a. Skrapar dhe i kishte lindur e drejta për t'u bërë aksionere në këtë shoqëri. Nuk kam dijeni, as unë dhe as bashkëshortja ime, \*\*\*.\*\*\*, për statusin aktual të këtij veprimi, si dhe deklaroj se nuk kam përfituar dividend nga \*\*\* sh. a.[...].*

13.4 Nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit <sup>16</sup>, referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2022, të \*\*\* sh.a., rezulton se, duke filluar nga data \*\*.4.2009: *[...] znj. \*\*\*.\*\*\* është regjistruar në Regjistrin e aksioneve të shoqërisë \*\*\* sh.a. dhe zotëron 50 aksione, me një vlerë totale prej 50.000 ALL, të cilat përbëjnë 0.00027% të kapitalit të \*\*\* sh.a., dhe z. Pëllumb \*\*\*. Zaimi është regjistruar në Regjistrin e aksioneve të shoqërisë \*\*\* sh.a. dhe zotëron 75 aksione, me një vlerë totale prej 75.000 ALL, të cilat përbëjnë 0.00041% të kapitalit të \*\*\* sh.a. Ky regjistrim është pasqyruar, gjithashtu, në Regjistrin Tregtar të Shoqërisë \*\*\*, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nga data e fitimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e shoqërisë \*\*\* sh.a. e deri në datën e këtij vërtetimi, Asambleja e Përgjithshme ka vendosur mosshpërndarjen e dividendëve [...].*

13.5 Komisioni i kërkoi informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat<sup>17</sup>, e cila, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.8.2022, ka dërguar informacion lidhur me zhvillimin e proceseve gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit me palë ndërgjyqëse shoqërinë “\*\*\*” sh.a. Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës, prej vitit 2014 e në vijim, ka zhvilluar 15 procese gjyqësore me këtë palë ndërgjyqëse në pozitën e kërkuesit apo palës paditëse,<sup>18</sup> me objekt të padisë: “Lëshim i Urdhrit të Ekzekutimit” apo “Përmbushje e detyrimit kontraktor”.

13.6 Gjithashtu, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2022, i kërkoi informacion Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), për të konfirmuar: (i) nëse shoqëria ku subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë dorëzuar bonot e privatizimit, është shpallur ndonjëherë fituese dhe, nëse po, sa ka qenë numri i kontratave të lidhura me institucione të ndryshme, si dhe (ii) nëse subjekti dhe bashkëshortja e tij janë të regjistruar në sistemin elektronik (SPE) dhe nëse kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik.

13.6.1 APP, në vijim, ka konfirmuar se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk janë të regjistruar në sistemin elektronik (SPE) dhe, për pasojë, nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronike; si dhe (ii) shoqëria “\*\*\*” sh.a. rezulton e regjistruar në SPE, ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në 443 procedura prokurimi.

13.7 Në përfundim të hetimit administrativ, për sa i takon kësaj çështjeje, Komisioni, në *Rezultatet e hetimit*,<sup>19</sup> i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të provuar me dokumentacion, pasi dukej se: *(i) subjekti i rivlerësimit është në shkelje të këtij parashikimi ligjor<sup>20</sup> në raport me ushtrimin e funksionit të tij, për shkak të*

<sup>16</sup> Subjekti ka paraqitur si dokument justifikues: (i) Formularin e kërkesave për blerje aksionesh për person fizik, me nr. serie \*\*\*; (ii) Formularin e kërkesave për blerje aksionesh për person fizik, me nr. serie \*\*\*; (iii) Vërtetim nr. \*\*\* dt. \*\*.4.2022, i “\*\*\*” sh.a.

<sup>17</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.8.2022, në dosje të Komisionit.

<sup>18</sup> Këto procese gjyqësore datojnë pas vitit 2008, vit i investimit si aksioner në këtë shoqëri, ndërkohë nga informacioni rezultojnë edhe katër procese të tjera prej vitit 1999-2002.

<sup>19</sup> Shihni f.18-19 të dokumentit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

<sup>20</sup> Komisioni ka arsyetuar se, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, konkretisht në pikën 1, të nenit 21, ku përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet

zotërimit të aksioneve në këtë shoqëri; (ii) bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, dukej se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, për faktin se ka gjykuar çështje të kësaj shoqërie, duke qenë njëkohësisht edhe aksioner i saj.

13.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, është shprehur:<sup>21</sup> se çështjet e gjykuara prej tij si gjyqtar, me palë “\*\*\*\*” sh.a., përfundimin e tyre së bashku me pasojat e sjella, për të cilat ka theksuar se vendimmarrjet nuk sjellin pasoja për palët në proces apo edhe për rastet e tjera të gjykuara, të cilat kanë përfunduar me vendime të formës së prerë. Po ashtu, subjekti ka referuar vendimin nr. 35, datë 23.11.2021, të Kolegjit, duke theksuar se vendimi interpreton dhe sqaron në mënyrë të detajuar se nuk jemi para rastit të konflikt të interesit, edhe kur subjekti është aksioner në një shoqëri, në rastin konkret në “\*\*\*\*” sh.a. Vlera e këtyre aksioneve është e papërfillshme, minimaliste (*de minimis*).

13.9 Komisioni, në përfundim për sa më sipër, ka vlerësuar: [...] se ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë zotëruar aksione pranë kësaj shoqërie, duket se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 72, pika 1, dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, por kjo shkelje nuk ka qenë në një nivel të tillë që mund të kualifikohet brenda përcaktimeve të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pikërisht duke konsideruar parashikimet në Komentarin e Bangalores apo e vlerësuar kjo edhe në funksion të përfundimit të këtyre çështjeve me vendim të formës së prerë dhe interesit minimalist, pasi në rrethanat faktike nuk rezulton të ketë asnjë pasojë nga veprimtaria e ushtruar nga subjekti në lidhje me shoqërinë, sa i takon zhvillimit të gjykimeve<sup>22</sup>[...].

13.10 Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, vlerëson se prapësimet e subjektit, si dhe qëndrimi i Komisionit nuk mbështeten në jurisprudencën dhe qëndrimet e Kolegjit në trajtimin e rasteve të ngjashme, lidhur me konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Në rastin konkret, ekzistenca e konfliktit të interesit sipas nenit 72, pika 1, dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton e provuar nga shqyrtimi dhe finalizimi i rreth 15 çështjeve gjyqësore, me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të zotërojnë aksione pranë kësaj shoqërie, ashtu sikurse dhe Kolegji është shprehur në vendimin nr. 35/2021<sup>23</sup>.

13.11 Në përfundim të shkakut të ankimit lidhur me këto çështje, Komisioneri Publik vlerëson se kjo gjendje e konfliktit të interesit e përsëritur, e vetme, nuk mund të prodhojë efektet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, apo nuk duket në një nivel të tillë që mund të kualifikonte rastin sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por këto rrethana, të padeklaruara nga subjekti dhe në Deklaratën “Vetting”, duhen vlerësuar në tërësi, në mënyrë kumulative, me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kritereve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

---

me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.

<sup>21</sup> Shihni f. 8-13 të aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022.

<sup>22</sup> Shihni f. 24, të vendimit.

<sup>23</sup> Referohuni prg. nr. 23.9 të tij.

### III. A/2 Vlerësimi i aftësive profesionale

14. Komisioni, pas njohjes me raportin e përditësuar të DSIK-së, ka kërkuar dhe administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, fashikujt penal të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni në vendim ka vërejtur se këto çështje paraqesin elemente, të cilat përbëjnë *indicie* për subjektin e rivlerësimit, *për sa i përket kriterit profesional* dhe, për rrjedhojë, trajtimin e tyre e kanë paraqitur në rubrikën: “*Gjetje të tjera*” të seksionit “*Vlerësimi profesional*”.

15. Komisioneri Publik, nisur dhe nga jurisprudenca e Kolegjit, vlerëson se shkeljet e konstatuara në dosjet penale që administrohen në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, marrin kuptim e tjetër peshë në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese<sup>24</sup>. Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se këto çështje, në kuptim të këtij procesi, duhen trajtuar si pjesë e rezultateve administrative mbi kontrollin e figurës, dhe Kolegji i merr parasysh ato në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

#### 16. *Vendim penal nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, për shtetasin \*\*\*,\*\*\**

16.1 Komisionit, nga aktet e dosjes<sup>25</sup>, i ka rezultuar se ndaj shtetasit \*\*\*,\*\*\*, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2018, për veprën penale: “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, mbi bazë të materialit të Drejtorisë Vendore të Policisë, Berat. Regjistrimi i procedimit penal është bërë mbi kallëzimin e shtetasit \*\*\*,\*\*\*, i cili është dëmtuar, pasi i ishte tërhequr pensioni i pleqërisë nga filiali “Posta Shqiptare”, zyra \*\*\*, nga punonjësi \*\*\*,\*\*\*. Gjatë gjykimit është konstatuar se personi nën hetim, \*\*\*,\*\*\*, është dënuar më parë për të njëjtin fakt penal, me vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, me katër muaj burgim, duke u aplikuar ndaj tij edhe neni 59 i K. Penal, pasi ndaj tij ishte regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2018, mbi kallëzimin e Filialit të “Postës Shqiptare” sh.a., për vjedhje të pensionit të shtetasit \*\*\*. Kërkuesi, përfaqësuesi i organit të akuzës, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën në këtë proces gjyqësor, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2018, kërkesë me të cilën është dakordësuar edhe personi nën hetim dhe, po ashtu, edhe viktima. Në të tilla kushte është vendosur pranimi i kërkesës së përfaqësuesit të organit të akuzës dhe, për pasojë, është vendosur pushimi i çështjes, vendim i cili rezulton të jetë i formës së prerë.

16.2 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>26</sup>, lidhur me këtë çështje, në kushtet e vërejtura se parashtrimi i çështjes më sipër i referohej thjesht dhe vetëm arsyetimit të vendimit gjyqësor të mëparshëm (nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019), Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë \*\*.9.2019, si dhe kërkesën/përmbajtjen e kërkesës të përfaqësuesit të organit të akuzës.

16.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka parashtruar<sup>27</sup> se: [...] *Me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat (Gjyqtar P. Zaimi) ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat. 2. Pushimin e çështjes penale nr.\*\*\* regjistri, dt. \*\*.11.2019, që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, dt. \*\*.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, për veprën penale: ‘Vjedhja duke shpërdoruar detyrën’, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, ndaj shtetasit nën hetim \*\*\*,\*\*\*, pasi shtetasi nën hetim është dënuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën vepër penale”. Ky vendim ka marrë formën e prerë në datën \*\*.1.2020 [...].*

<sup>24</sup> Referohuni vendimit nr.16/2021, prg. 92.

<sup>25</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2019, përcjellë në Komision me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat.

<sup>26</sup> Shihni f. 39, të aktit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

<sup>27</sup> Shihni f. 20, të aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022.*



16.4 Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstaton ndonjë problematikë faktike e ligjore që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit<sup>28</sup>.

16.5 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi vlerëson se nuk qëndron disponimi nga gjyqtari se: *i pandehuri është dënuar me vendim të formës së prerë për të njëjtën veprë penale*, për këto arsye:

16.5.1 Vendimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit ka për *palë* kërkuese Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, shtetas nën hetim, \*\*\*.\*\*\*, dhe *viktimë* shtetasin \*\*\*.\*\*\*. Objekti i kësaj çështjeje penale është shqyrtimi i kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2018, për veprën penale: “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Ndërsa vendimi penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me gjyqtare znj. \*\*\*.\*\*\*, ka për palë në cilësinë e *të pandehurit* shtetasin \*\*\*.\*\*\*, me *viktimë* Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., Filiali Berat, me *akuzë* për kryerjen e veprës penale: “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, sipas procedimit penal nr.\*\*\*, datë \*\*.10.2018.

16.5.2 Nga përmbajtja e vendimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, i cili ka shërbyer si mbështetje ligjore për të disponuar me vendimin e pranimit të kërkesës së pushimit të çështjes penale nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2019, rezulton se persona të dëmtuar, të cilët kanë dhënë deklaratime pranë kallëzuesit Posta Shqiptare sh.a., Filiali Berat, janë disa shtetas, mes të cilëve shtetasi \*\*\*.\*\*\* nuk rezulton të ketë qenë, duke mos pasur asnjë pozitë procedurale. Në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, në pjesën arsyetuese ku përshkruhen rrethanat lehtësuese, citohet edhe Deklaratë noteriale e datës \*\*.6.2019, e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, por jo në cilësinë e personit të dëmtuar, pra duke u evidentuar fakti se shtetasi \*\*\*.\*\*\* nuk ka qenë në grupin e personave të dëmtuar, në episodin për të cilin ka bërë kallëzim Filiali Berat i Postës Shqiptare sh.a.

16.6 Komisioneri Publik konstaton se, për sa kohë kjo çështje është trajtuar nga Komisioni në kuadër të të dhënave të administruara si rezultat i *informacioneve të organeve ligjzbatuese*, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e pasurisë dhe të aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**17. Vendim penal nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, për shtetasin \*\*\*.\*\*\***

17.1 Komisionit, nga aktet e dosjes<sup>29</sup>, i ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, ka regjistruar çështjen penale me nr. \*\*\* regjistri, datë \*\*.12.2013, kundër shtetasit \*\*\*.\*\*\*, i dyshuar për kryerjen e veprës penale: “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Prokuroria i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, ku subjekti i rivlerësimit është trupi gjyqësor, ka vendosur: [...] të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë ndaj shtetasit \*\*\*.\*\*\*...dhe të caktojë si masë sigurimi atë: *të detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore* [...].

<sup>28</sup> Shihni f. 33, të vendimit.

<sup>29</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2013, përcjellë në Komision me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat.

17.2 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>30</sup>, lidhur me këtë çështje, Komisioni, pasi ka pasqyruar rrethanat e çështjes se: [...] ndër të tjera, subjekti ka arsytuar në vendimin e tij kriteret e nenit 229 të K. Pr. Penale, duke cituar se mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të parashikuara në Kodin Penal, shtetasi \*\*\* nuk njihet si person me tendenca kriminale dhe nuk rezulton person i dënuar...ai njihet si person punëtor, korrekt në shoqëri dhe me sjellje të mirë. Vendimi më tej është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e saj nr. \*\*, datë \*\*.2.2014, ka vendosur mospranimin e ankimit të organit të akuzës, për shkak të heqjes dorë nga ankimi nga përfaqësuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Vlorë [...] i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të depozitohet dokumentacionin që provon gjendjen gjyqësore të të akuzuarit, sikurse theksohet në vendim se ai ka rezultuar i padënuar, si dhe çdo dokumentacion që ka ndikuar në provueshmërinë e rrethanave lehtësuese.

17.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi ka cituar disa vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku si masë sigurimi personal është vendosur: *detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*, ka parashtruar<sup>31</sup> se: [...] a) nga akti nr.1 (kërkesa e prokurorit për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit, datë \*\*.1.2013, rezulton se ky akt është hartuar (përpiluar nga prokurori \*\*\*,\*\*\*, ku i arrestuari në flagrancë, shtetasi \*\*\*,\*\*\*, ka këto të dhëna (gjeneralitete) ... me gjendje civile i martuar , me gjendje gjyqësore i padënuar. b) Në aktet nr. 2-4 (informacion për referimin e veprës penale në prokurori, dhjetor 2013, procesverbal i deklarimit të shtetasit në hetim ....ku shtetasi shtetasi \*\*\*,\*\*\*, ka këto të dhëna (gjeneralitete)... me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar [...].

17.4 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se nuk evidentohen problematika lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016, që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit<sup>32</sup>.

17.5 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi vlerëson se duhet të tregonte kujdesin e nevojshëm, bazuar në kërkesat e paragrafit 1, të nenit 382, të Kodit të Procedurës Penale, duke administruar në cilësinë e provës, aktin përkatës/vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasit \*\*\*,\*\*\*, lëshuar nga organi i përcaktuar në nenin 484 të Kodit të Procedurës Penale.

18. Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 25 denoncime/ankesa nga publiku. Komisioni, pas analizimit të tyre, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se, në tërësi, ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

19. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm mbi rrethanat e konstatuara, pasi duket se pretendimet e disa prej denoncuesve gjejnë mbështetje në aktet në dosje, konkretisht:

20. **Denoncim<sup>33</sup> i shtetasit \*\*\*,\*\*\*,** Komisioni ka parashtruar se ky shtetas pretendon se subjekti i rivlerësimit ka shkelje të etikës profesionale të gjyqtarit, duke përdorur një fjalor arrogant, aspak etik dhe joprofesional, dhe pasqyron në denoncim dhe një komunikim të shkurtër mes palës ndërgjyqëse, duke pretenduar se subjekti ka përjashtuar disa herë nga seanca personin e interesuar në proces, shtetasin \*\*\*,\*\*\*. Po ashtu, denoncuesi pretendon dhe për shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit, lidhur me mosparaqitjen e të akuzuarit si rezultat i mosnjohimit.

<sup>30</sup> Shihni f. 37-38, të aktit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit*, z. Pëllumb Zaimi.

<sup>31</sup> Shihni f.16-20, të aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit*.

<sup>32</sup> Shihni f.31, të vendimit.

<sup>33</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.7.2020.

20.1 Komisioni<sup>34</sup> kërkoi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat kopje të dosjes gjyqësore mbi çështjen nr. \*\*\*, me palë shtetasit \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, të cilët janë ankuar ndaj vendimit të prokurorit \*\*\*. “Për mosfillimin e procedimit penal”, lidhur me një kallëzim penal, të bërë nga këta shtetas ndaj shtetasit \*\*\*, për veprën penale “Pushim i cenimit të posedimit të pronës dhe zaptimit të saj me dhunë”, së bashku me CD-në përkatëse<sup>35</sup>, të cilat janë administruar nga Komisioni.

20.2 Nga aktet e administruara rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, me vendimin nr.\*\*\* datë \*\*.7.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesve \*\*\*, \*\*\*/\*\*, \*\*\*, me objekt kundërshtimin e vendimit datë \*\*.2.2020, të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat “Për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues me nr. \*\*\* të vitit 2020”, pasi del qartë që fakti nuk ekziston.

20.3 Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*, datë \*\*.3.2021, në lidhje me themelin e gjykimit, ka çmuar se ndaj vendimit gjyqësor penal nr.\*\*\*, datë \*\*.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, duhet të vendoset mospranimi i ankimit, për shkak të heqjes dorë nga ankuesit. Gjykata e Apelit Vlorë, në referim të nenit 420/1/ç të K. Pr. Penale shprehet se: [...] *pa diskutuar në lidhje me bazueshmërinë ose jo të vendimit të ankimit, do të vendosë mospranimin e ankimit, për shkak të heqjes dorë prej tij nga ana e ankuesve [...]*.

20.4 Komisioni, sa i përket pretendimit të denoncuesit për shkelje të etikës nga subjekti në komunikim, nga dëgjesa e bërë CD-së, ndër të tjera, ka konstatuar hera-herës shprehje drejtuar palës ndërgjyqëse, të cilat duken joetike për figurën e magjistratit, tej komunikimit zyrtar.

20.5 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>36</sup>, lidhur me këtë çështje, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, dhe i kërkoi të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion, pasi duket se shprehjet drejtuar palës ndërgjyqëse, gjatë komunikimit, janë joetike për figurën e magjistratit dhe cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore (parimin e Integritetit, Sjelljes së hijshme dhe Vetëpërbajtjes, Respektit dhe Aftësisë për të dëgjuar etj.), miratuar me vendimin nr. 171, datë 22.4.2021, të KLGJ-së.

20.6 Subjekti i rivlerësimit<sup>37</sup>, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka kundërshtuar këto konstatime të Komisionit, duke iu referuar kuptimit të fjalëve të përdorura sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe dhe rrethanave të zhvillimit të seancës gjyqësore.

20.7 Mbi këto pretendime të subjektit, Komisioni ka arritur në përfundimin<sup>38</sup>se: [...] *duke pasur në konsideratë faktin e përdorimit të shprehjeve jo të duhura gjatë ushtrimit të detyrës, ku kërkohet solemnitet dhe në raport me vendin e përdorimit të tyre, çmon se subjekti, si magjistrat në sistemin e drejtësisë, duhet të evitojë çdo fjalor joetik, pavarësisht situatës që e dikton atë. Në konkluzion, trupi gjyqësor, në raport me shpjegimet e subjektit mbi rrethanën që i ka përdorur këto shprehje, vlerëson se kjo mangësi, duke qenë një rast i veçuar në veprimtarinë e punës së subjektit, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut të qenësishëm për penalizim të tij. Ndërsa, lidhur me ankimin e denoncuesit mbi themelin e çështjes, Komisioni, nga verifikimi i akteve të administruara, vëren se palët, ankues - i kallëzuarit, kanë normalizuar marrëdhëniet dhe, për këtë shkak, nga Gjykata e Apelit Vlorë është vendosur mospranimi i ankimit [...]*.

20.8 Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, vlerëson se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në komunikimin mes tij dhe palëve ndërgjyqëse, në funksion të qëllimit të procesit

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.5.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat.

<sup>35</sup> Në pamundësi të aksesit të informacionit të CD-së, për shkak të formatit të saj, Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.8.2022, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, ridërgimin në formatin Media Player (MP3). Komisioneri Publik i referohet saktësisht rezultateve të hetimit dhe vendimit të Komisionit.

<sup>36</sup> Shihni f. 41, të dokumentit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

<sup>37</sup> Shihni f. 21-23 të dokumentit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit.*

<sup>38</sup> Shihni f. 36, të vendimit.

të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, përbëjnë sjellje që nuk i shërben këtij qëllimi.

20.9 Sikundër konstaton dhe Komisioni, verifikohet se subjekti ka përdorur shprehje joetike për figurën e magjistratit, të tilla që cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore, (parimin e Integritetit, Sjelljes së hijshme dhe Vetëpërmbytjes, Respektit dhe Aftësisë për të dëgjuar etj.), duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 75, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhen vlerësuar nga Kolegji në tërësi, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

**21. Denoncim<sup>39</sup> i shtetasit \*\*\*.\*\*\*.** Ky shtetas, së bashku me bashkëshorten e tij, ankohen për vendim të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin njëkohësisht deklarojnë se kanë ushtruar edhe të drejtën ankimore. Sipas parashtrimeve në denoncim, ata janë dënuar me gjobë për veprën penale “Dëmtime të kryera me dashje”, ndaj shtetasit \*\*\*.\*\*\*. Për këtë çështje, denoncuesit ankohen se janë dënuar me pa të drejtë, se në dëm të tyre janë sajuar situata. Në tërësi, ata kërkojnë të zbardhet situata e krijuar.

21.1 Denoncuesit kanë depozituar së bashku me denoncimin këto akte: (i) Ankim kundër vendimit penal nr. \*\*\* , datë \*\*.12.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, që mban datën \*\*.1.2021; (ii) Vendim penal nr. \*\*\* datë \*\*.12.2020, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, me palë kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Berat, kundër të pandehurve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, viktimë \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*; (iii) Vendim penal nr. \*\*\* , datë \*\*.12.2019, me gjyqtare znj. \*\*\*.\*\*\*, me palë i dëmtuar akuzues \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, dhe i akuzuar \*\*\*.\*\*\*; (iv) Vendim penal nr. \*\*\* , datë \*\*.10.2021, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, me palë viktimë akuzuese \*\*\*.\*\*\* dhe të akuzuar \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.

21.2 Nga aktet e administruara vërehet se, për ngjarjen e ndodhur më datë \*\*.5.2019, në fshatin \*\*\* , Njësia Administrative Poshnje, Bashkia Dimal/Ura Vajgurore, midis shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe shtetasve \*\*\* e \*\*\*.\*\*\* rezultojnë dy vendime gjyqësore penale. Sipas momentit kronologjik rezultojnë këto vendimmarrje të Gjykatës:

21.2.1 *Vendimi i parë penal<sup>40</sup>* me nr. \*\*\* , datë \*\*.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me gjyqtar znj. \*\*\*.\*\*\*, ka për palë *i dëmtuar akuzues \*\*\* e \*\*\*.\*\*\*, i akuzuar \*\*\*.\*\*\*, me akuzë për kryerjen e veprës penale: “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal. Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka vendosur deklarinim fajtor të të akuzuarit \*\*\*.\*\*\* për kryerjen e veprës penale: “Dëmtime të tjera me dashje”, vepër e parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të kësaj dispozite me 50.000 lekë gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*.6.2020, për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale fajësinë dhe shpenzimet gjyqësore, dhe ndryshimin për pjesën tjetër, duke e dënuar me 1 (një) muaj burg të akuzuarin \*\*\*.\*\*\*.*

21.2.2 *Vendimi i dytë penal<sup>41</sup>* me nr. \*\*\* , datë \*\*.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, me gjyqtar subjektin, z. Zaimi, ka për palë *viktimë akuzuese \*\*\*.\*\*\*, të akuzuar \*\*\* e \*\*\*.\*\*\*, me akuzë për kryerjen e veprës penale: “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal. Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka vendosur deklarinim fajtor të të akuzuarit \*\*\*.\*\*\* dhe të akuzuarës \*\*\*.\*\*\*, për kryerjen e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, vepër e parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal dhe dënimin e zotit \*\*\*.\*\*\* me 60.000 lekë gjobë dhe znj. \*\*\*.\*\*\* me 50.000 lekë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\* , datë \*\*.9.2022.*

21.3 Gjithashtu, midis familjeve \*\*\* dhe \*\*\* ka pasur një konflikt të hapur për një vjedhje në bashkëpunim (për një procedim të regjistruar në vitin 2018), të shkaktuar nga vëllai i shtetasit \*\*\* ,

<sup>39</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2022.

<sup>40</sup> Nga verifikimi i këtij vendimi rezulton se janë administruar në cilësinë e provës 3 akte mjeko-ligjore, për të tre shtetasit në konflikt: (1) Akt mjeko-ligjor me nr. \*\*, datë \*\*.5.2019, për shtetasin \*\*\*.\*\*\*; (2) Akt mjeko-ligjor me nr. \*\*, datë \*\*.5.2019, për shtetasin \*\*\*.\*\*\* dhe (3) Akt mjeko-ligjor me nr. \*\*, datë \*\*.5.2019, për shtetasin \*\*\*.\*\*\*.

<sup>41</sup> Nga verifikimi i këtij vendimi rezulton se është administruar në cilësinë e provës: 1 (një) akt mjeko-ligjor me nr. \*\*, datë \*\*.5.2019, për shtetasin \*\*\*.\*\*\*.

çështje kjo e hetuar dhe e përfunduar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.12.2020, me të cilin shtetasit \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\* janë dënuar përkatësisht me 9 muaj dhe 6 muaj burgim, duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit dhe vendosur vënia e të dënuarve në periudhë prove. Ky vendim rezultoi i ankimuar nga organi i akuzës, pasi ky i fundit nuk ka qenë dakord me aplikimin e nenit 59 në vendimmarrje/me pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal. Më tej, rezultoi se situata ka vijuar të përshkallëzohet dhe kanë vijuar konfliktet me vëllain e shtetasit \*\*\*,\*\*\*, shtetasin \*\*\*,\*\*\*.

21.4 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>42</sup>, lidhur me këtë çështje, Komisioni, ndër të tjera, parashtron se: [...] *Nga verifikimi i vendimit të parë, datë \*\*.12.2019 (dhënë nga një subjekt tjetër), rezultoi se për të tre shtetasit cilësohen dhe arsyetohet mbi secilin raport mjekësor të tyre dhe, po ashtu, edhe në vendimin e subjektit të rivlerësimit duket se sërish gjykohet po për të njëjtën çështje dhe po mbi të njëjtat prova, më konkretisht arsyetohet dhe konkludohet duke u bazuar sërish në të njëjtin raport mjekësor dhënë shtetasit \*\*\*,\*\*\*, provë kjo që duket se është vlerësuar njëherë që në gjykimin e parë nga ku dhe gjykata ka konkluduar në fajësinë e këtij shtetasi dhe dënimin e tij me një muaj burgim, ndërsa në rastin e gjykuar nga subjekti dënohen shtetasit \*\*\*,...Duket se në vendimin e subjektit të rivlerësimit nuk identifikohet asnjë e dhënë në lidhje me dënimin e shtetasit \*\*\*,\*\*\*, me 1 muaj burgim, dy vite më parë, për të njëjtën çështje. Në këtë vendim, organi i akuzës ka kërkuar deklarinë e pafajshëm të shtetasve \*\*\*,\*\*\* [...].*

21.5 Në përfundim, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me: [...] (i) *të jepni shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesve për ngjarjen e ndodhur në maj të vitit 2019, për të cilën janë dënuar respektivisht: në vitin 2019, shtetasi \*\*\*,\*\*\* dhe në vitin 2021, shtetasit \*\*\*,\*\*\* dhe ku, si provë, në të dyja rastet, është administruar Akti mjeko-ligjor nr.\*\*, datë \*\*.5.2019. Shpjegimet e dhëna të konsiderohen edhe në raport me kërkimin e organit të akuzës për të deklaruar të pafajshëm të akuzuarit. (ii) Të qartësoni dhe depozitoni dokumentacion, mbi situatën e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë për dënimin e shtetasit \*\*\*,\*\*\* me 1 muaj burgim.; (iii) Të depozitoni diskutimin përfundimtar të përfaqësuesit të organit të akuzës në këtë çështje, të gjykuar nga ana juaj, vënë në lëvizje nga kërkesa penale e shtetasit \*\*\*,\*\*\* [...].*

21.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, është shprehur se:<sup>43</sup> [...] *Nga procesverbalet gjyqësore të çështjes (kërkesa penale me nr.\*\*\*, datë \*\*.5.2021) rezultoi se prokurori \*\*\*,\*\*\* ka marrë pjesë në gjykimin penal dhe në seancën gjyqësore, datë \*\*.10.2021, në diskutimin përfundimtar me gojë (verbalisht), ka kërkuar: Deklarimin të pafajshëm të të akuzuarve \*\*\*,\*\*\* e \*\*\*,\*\*\*, pasi nuk u provua se kanë kryer kundërvajtjen penale që akuzohen...Të dyja kërkesat penale nr. \*\*\*/2021 dhe nr. \*\*\*/2019 bëjnë fjalë për kundërvajtjen penale: “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal. Të dyja kërkesat penale të sipërcituara janë gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Berat, nga trupa gjykes të ndryshëm, të përbërë nga gjyqtar \*\*\*,\*\*\* dhe gjyqtar Pëllumb Zaimi, në kohë (në periudha) të ndryshme...Të akuzuarit \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\* nuk kanë paraqitur në gjykim asnjë provë për të provuar pretendimet/pafajësinë e tyre... Në lidhje me ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë nr.\*\*\*, datë \*\*.6.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ndaj të akuzuarit \*\*\*,\*\*\*, në bazë të nenit 462 e vijues, të Kodit të Procedurës Penale, me ekzekutimin e vendimeve penale merret Prokurori[...].*

21.7 Komisioni arrin në përfundimin<sup>44</sup>se: [...] *në vlerësim të shpjegimeve të dhëna, legjislacionit të aplikueshëm, i cili në këto raste i jep të drejtë secilës palë të dëmtuar në mënyrë të veçantë të ushtrisë ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë, si dhe faktit që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është ligjëruar nga gjykata më e lartë, nuk konstatohet problematika, të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit [...].*

<sup>42</sup> Shihni f. 45-46, të aktit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.*

<sup>43</sup> Referohuni f. 30-33, të aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit.*

<sup>44</sup>Shihni f. 41, të vendimit.

21.8 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi vlerëson se nga të dhënat e administruara nga denoncimi, konstatohen problematika në treguesin e njohurive ligjore, sipas nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, të cilat duhen evidentuar dhe çmuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në mënyrë kumulative me ato të trajtuara në këtë ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

21.9 *Së pari*, Komisioneri Publik vlerëson se *fakti që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është ligjëruar nga gjykata më e lartë*, nuk mund të jenë kriteri matës i vetëm përcaktues për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për më tepër kur lidhet me aspekte të respektimit të ligjit procedural, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij. Qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta nuk duhen përdorur për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët.<sup>45</sup>

21.10 *Së dyti*, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në vendimin penal nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Berat, ka disponuar duke shpallur fajtor shtetas, të cilët më parë, për të njëjtën vepër penale, për të njëjtin konflikt, mbi të njëjtat prova shpresore, kanë qenë palë akuzuese dhe, me vendim gjykate, kanë provuar se kanë qenë të dëmtuar nga personi/kërkuesi, duke u deklaruar ky i fundit fajtor me vendim të formës së prerë për të njëjtin fakt.

21.11 Në përfundim për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik, nisur dhe nga argumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, vlerëson se ka elemente për t'u vlerësuar në drejtim të indikatorit të aspektit të njohurive ligjore, referuar nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht mbi interpretimin e parimeve ligjore, që rregullojnë institutin e sigurisë juridike.

21.12 **Denoncim<sup>46</sup> i shtetasit \*\*\*.\*\*\***. Shtetasi \*\*\*.\*\*\* (i ati i njërit prej personave në hetim, \*\*\*.\*\*\* (\*\*\*), i është drejtuar Komisionit, duke u ankuar ndaj qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes penale, ku *kërkues/i pandehur* është edhe i biri, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, konkretisht, gjatë gjykimit, trupi gjykues në vijimësi ka mbajtur qëndrime haptazi të njëanshme kundër të drejtave të të pandehurve në procesin penal, si dhe ka marrë vendime procedurale shumë të rëndësishme në kundërshtim të hapur me ligjin dhe në dëm të lirisë dhe objektivitetit të gjykimit.

21.13 Aktet në dosje të Komisionit dëshmojnë se, nga hetimi administrativ i kryer, u vërejt se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar i deleguar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë çështjen penale me të pandehurit/kërkuesit \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*. Janë administruar gjashtë vendime me të njëjtin trup gjykues, ku pjesë përbërëse është edhe subjekti i rivlerësimit, me objekt kërkese: "*Shuarje e masës së sigurimit*", për shkak të kalimit të afatit të paraburgimit, përkatësisht për dosjen me nr. akti \*\*\*, në datat \*\*.2.2022, \*\*.3.2022, \*\*.4.2022, \*\*.5.2022, \*\*.7.2022, \*\*.9.2022.

21.14 Ankuesi pretendon se është shkelur afati 12-mujor i qëndrimit të të pandehurve në paraburgim dhe, për pasojë, është shkelur neni 263/2 i Kodit të Procedurës Penale, pasi sipas tyre praktika njësuese e Kolegjit të Gjykatës së Lartë<sup>47</sup>, afatin 12-mujor e parashikon të nisur prej momentit të dorëzimit të akteve për gjykim, në gjykatë, nga organi i akuzës (që sipas tyre është data \*\*.11.2020), për rastet kur nga gjyqtari paraprak është vendosur kalimi i çështjes për gjykim. Ankuesit pretendojnë se deri aktualisht janë mbushur 22 muaj që të pandehurit qëndrojnë në burg dhe se për ta ende nuk është dhënë vendimi në shkallë të parë.

21.15 Në *Rezultatet e hetimit*<sup>48</sup>, lidhur me këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë çdo dokumentacion mbështetës, për këto konstatime: [...] (i) duke

<sup>45</sup> Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 28/2020.

<sup>46</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.9.2022.

<sup>47</sup> Vendimi nr. 62, datë 1.11.2021, nga ky vendim citohet pika 42/2: "*Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq...*".

<sup>48</sup> Shihni f. 47-49, të aktit: *Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi*.

se vendimmarrjet e dhëna nga trupi gjykues (ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit), pas praktikës njehsuese të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, nuk janë vlerësuar në raport me këtë të fundit dhe parashikimin ligjor të figurës dhe rolit të gjyqtarit të seancës paraprake; (ii) dukej se në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2021, është interpretuar gabim ligji procedural penal, sikurse është shprehur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në arsyetimin e bërë, në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2022, pikat 28 dhe 29 [...].

21.16 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtime<sup>49</sup> ka shpjeguar se: [...] (i) në këtë gjykim nuk ka pasur asnjëherë rolin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka qenë anëtar i trupit gjykues që po shqyrton themelin e çështjes; (ii) në asnjë vendimmarrje të marrë nga trupi gjykues ku bën pjesë, nuk është diskutuar roli i gjyqtarit të seancës paraprake dhe as llogaritja e afateve të paraburgimit, që ecin gjatë fazës së seancës paraprake, por është zbatuar afati tërësor i paraburgimit sipas nenit 263, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale; (iii) trupi gjykues ku bën pjesë ka rrëzuar kërkesat e të pandehurve me objekt shuarjen e masave të sigurimit “arresti në burg”, të caktuara ndaj tyre me vendimet e datave \*\*.2.2022, \*\*.3.2022, \*\*.4.2022 dhe \*\*.5.2022 dhe, në këtë kohë, vendimi njehsues nuk ishte zbardhur dhe nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare; (iv) dy nga vendimet e dhëna nga ky trup gjykues, konkretisht, vendimet e datave \*\*.2.2022 dhe \*\*.3.2022, kanë qenë objekt ankimi dhe janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimet nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2022 dhe \*\*\*, datë \*\*.4.2022, ka vendosur lënien e tyre në fuqi dhe se këto dy vendime nuk janë ankimuar; (v) të gjitha vendimmarrjet e trupit gjykues ku ka qenë pjesë, bazohen në afatin tërësor të paraburgimit dhe dy prej tyre janë lënë në fuqi, ndërsa të tjerat, duke filluar nga ajo e datës \*\*.4.2022 janë ankimuar dhe ende nuk është marrë ndonjë vendim nga Gjykata e Apelit Vlorë; (vi) edhe pse është marrë vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka shqyrtuar një vendim që nuk ishte dhënë prej tij, sërish Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë urdhëruar lirimin e të pandehurve, për shkak të kalimit të afatit dhe as nuk është shprehur në ndonjë pikë të arsyetimit se nuk duhet të zbatohen afatet tërësore të paraburgimit; (vii) në rastin konkret, ankesat/kallëzimet janë tentuar të përdoren si formë intimidimi ndaj trupit gjykues. Subjekti ka depozituar të gjitha vendimet gjyqësore të gjykatave, procesverbale të seancave gjyqësore, vendimin e mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, si dhe vendimin e lënies në fuqi të vendimit të mosfillimit etj. [...].

21.17 Komisioni arrin në përfundimin<sup>50</sup> se: [...] (i) për sa kohë çështja duket të jetë komplekse, (ii) po ashtu për sa rezultoi se për kërkesat e shuarjes së masës së sigurimit janë ndërmarrë një sërë veprimesh apo edhe vendimmarrje, (iii) në një kohë që Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk është shprehur lidhur me afatin tërësor të paraburgimit, (iv) pa zëvendësuar logjikën e arsyetimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk mund të konkludojë në problematika ndaj subjektit të rivlerësimit [...].

21.18 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në treguesin e njohurive ligjore sipas nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, pasi vendimi i ndërmjetëm, datë \*\*.2.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ku një nga anëtarët është subjekti i rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të dhëna të marra nga burime të hapura të informacionit, rezulton të jetë prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë<sup>51</sup>.

21.18.1 Me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*.4.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

<sup>49</sup> Shihni f. 33-38, të aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit*.

<sup>50</sup> Shihni f. 45, të vendimit.

<sup>51</sup> [https://www.gjykataelarte.gov.al/gjl\\_ceshtje\\_detaje.php?caseId\\_sel=2022-01437&ln=Lng1&uni=20221124154108134059889912669286](https://www.gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2022-01437&ln=Lng1&uni=20221124154108134059889912669286).

21.18.2 Në vendimin e tij nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të gabuar arsyetimin dhe disponimin e gjykatave të faktit në rastin konkret, duke parashtruar argumentet dhe interpretimin gjyqësor, përkatësisht në paragrafët nr. 11-18 të këtij vendimi.

### **III.B. Lidhur me gjetjet në kontrollin e pasurisë**

**22.** Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike).

**23.** Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie”, dorëzuar në ILDKPKI më datë 15.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017.

**24.** Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet dhe i paraqesim në vijim për trajtim Kolegjit, rrethanat lidhur me sa vijon:

#### **25. Pasuria “Apartament me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>”, ndodhur në \*\*\*, Tiranë**

25.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit deklaron: Apartament banimi me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, vol. \*\*, f.\*\*, zona kadastrale \*\*\*, ndodhur në \*\*\*, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë. Krijuar me kontratë sipërmarrje datë \*\*.6.2007 dhe kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.8.2016, me vlerë 48.700 euro. *Burimi i krijimit:* Të ardhura familjare + të ardhurat nga shitja e apartamentit në Çorovodë, me kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.4.2016. *Vlera:* 6.164.870 lekë. *Pjesa takuese:* 50%.

25.2 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar lidhur me këtë pasuri.

25.3 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit deklaron: Shtuar sipërfaqe banimi 97,4 m<sup>2</sup>, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë \*\*.6.2007, në shumën 48.700 euro. Nga kursimet familjare të viteve të patura gjendje *cash* në shtëpi, depozita bankare, *kontributi i \*\*\*,\*\*\* (\*\*\*)* nga dhuratat e saj në vite<sup>52</sup>, në shumën 37.000 euro. Pakësuar 37.000 euro për pagim këstesh, sipas kontratës së sipërmarrjes datë \*\*.6.2007.

25.3.1 Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “*Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridike dhe Fizike*”, subjekti i rivlerësimit deklaron: Kontrata e sipërmarrjes, datë \*\*.6.2007 e në vazhdim. Shlyer 37.000 euro, detyrimi i mbetur 11.700 euro.

25.4 Në deklaratat periodike për vitet 2009-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin e mbetur prej 11.700 euro.

25.5 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit deklaron: Shlyerje e kontratës së sipërmarrjes, datë \*\*.6.2007, në shumën totale 48.700 euro ose 6.164.870 lekë, sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.8.2016, dhe pagimi i këstit të fundit të detyrimit të kontratës në shumën 11.700 euro ose 1.605.000 lekë. Të ardhura të siguruara nga shitja e apartamentit në Çorovodë, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.4.2016. *Pjesa takuese:* 50%.

---

<sup>52</sup> Vajza e subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur me të, në deklaratën e saj të vitit 2008, deklaron: “*Të ardhurat nga dhuratat në vite deri në moshë madhore. Gjithsej shuma 4.000 euro = 500.000 lekë. Pakësuar 2.000 euro, dhënë familjes sime gjatë vitit 2008, për mbylljen e këstit të kontratës së sipërmarrjes*”.



25.6 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1<sup>53</sup>, konfirmon se në emër të Pëllumb dhe \*\*\*.\*\*\* është regjistruar pasuria *Apartament*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*, f.\*\*, ZK \*\*\*, me sip. 86 m<sup>2</sup> (pasuri aktive).

25.7 Në dosje të Komisionit, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, janë administruar: (i) Kontratë Sipërmarrje e datës \*\*.6.2007, vërtetuar me nr. \*\*\* rep., datë \*\*.6.2007, me palë sipërmarrëse \*\*\*.\*\*\*, “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë porositëse Pëllumb Zaimi, për apartamentin me sipërfaqe totale ndërtimi 97,4 m<sup>2</sup>, në adresën \*\*\*.\*\*\*, Dajt, Tiranë, në vlerën 48.700 euro; si dhe (ii) Kontratë Shitje me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.8.2016. Me anë të kësaj kontrate, pala shitëse, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., i ka shitur palës blerëse, Pëllumb dhe \*\*\*.\*\*\*, apartamentin me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup> me numër pasurie \*\*\*, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, kundrejt çmimit 48.700 euro<sup>54</sup>.

25.8 *Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie*, rezulton se Komisioni ka analizuar secilin prej burimeve të deklaruar nga subjekti, në deklaratën periodike për vitin 2008, dhe në përfundim të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të rezultuara gjatë hetimit, si dhe i ka kërkuar shpjegime, pasi: (i) Duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare, në vlerën 212.256 lekë, për vitin 2005, dhe 162.414 lekë, për vitin 2008, të krijojë kursimet në *cash*, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare. (ii) Duket se subjekti nuk ka pasur mundësi, në vlerën 649.183 lekë, të paguajë këstet e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare. (iii) Subjekti nuk ka deklaruar në Deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2007, kontratën e sipërmarrjes, datë \*\*.6.2007, për apartamentin e banimit me sip. 97,4 m<sup>2</sup>, të ndodhur në \*\*\*.\*\*\*, si dhe pagesën e këstit të parë, prej 22.000 euro. Kjo kontratë dhe pagesat janë deklaruar në vitin 2008.

25.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur shpjegime dhe ka depozituar prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës<sup>55</sup>.

25.10 Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *viti 2005 mbetet sërish në një balancë negative në vlerën 212.256 lekë ... Lidhur me këstin e parë, të paguar në datën \*\*.6.2007... nga përlllogaritjet financiare mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit në datën e investimit, jo vetëm për të kryer këtë pagesë, por edhe për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe për të krijuar kursimet e tij në datën \*\*.6.2007, trupi gjykues çmon se, edhe nëse aplikohet marzhi i mundësisë së kursimit 0 (zero), në datën \*\*.6.2007, rezulton se mundësia financiare e subjektit për të paguar këtë këst, si dhe për të përballuar shpenzimet, është në balancë të papërfillshme negative prej 5.794 lekësh. Pra, edhe nëse i qëndrohet variantit që deri në datën \*\*.6.2007 kursimi i subjektit ishte zero, duke analizuar transaksionet e kryera prej tij dhe, më konkretisht, tërheqjen nga llogaria e tij në \*\*\* Bank të shumës 750.000 lekë, në datën \*\*.8.2007, si dhe shumës 272.000 lekë, në datën \*\*.12.2007, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të krijojë shumën 8.000 euro cash në gjashtëmujorin e mbetur të vitit. Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2008, Komisioni konstaton se ... rezultati financiar në datën e pagesës është i pandryshuar, ndërsa ai vjetor mbetet me një balancë negative në vlerën 142.189 lekë[...].*

25.11 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti rezulton me një balancë negative në shumën 212.256 lekë, për vitin 2005, dhe në shumën 142.189 lekë, për vitin 2008. Nisur nga masa dhe dinamika e pamjaftueshmërisë financiare të lartpërmendur, ka vlerësuar se, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, në raport me rezultatet e tjera në tërësinë

<sup>53</sup> Referohuni shkresës së ASHK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2020.

<sup>54</sup> Në kontratën e shitjes është përcaktuar se shlyerja e shumës është kryer respektivisht: (i) 22.000 euro sipas mandatpagesës së datës \*\*.6.2007; (ii) 10.000 euro sipas mandatpagesës së datës \*\*.6.2008; (iii) 5.000 euro sipas mandatpagesës së datës \*\*.9.2008; ndërsa (iv) shuma prej 11.700 euro, sipas transaksionin bankar të datës \*\*.8.2016, në llogarinë e noteres.

<sup>55</sup> Referohuni aktit: *Shpjegime lidhur me raportin përfundimtar të kontrollit*, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.10.2022.

e procesit të rivlerësimit, pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale - 354.445 lekë, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe/ose nenit 61 të ligjit nr. 84/2016<sup>56</sup>.

25.12 Komisioneri Publik, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë: “*Apartament banimi, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>*”, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, përveç sa konstatuar nga Komisioni lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për të kursyer dhe për të përballuar shpenzimet për vitet 2005 dhe 2008, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme kursimet, shpenzimet dhe pagesat e kryera edhe në vitin 2007.

25.13 Në ndryshim nga Komisioni, vlerësojmë se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhen përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së/INSTAT dhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>57</sup>, të cilat në total për familjen e subjektit, për vitin 2007, llogariten në vlerën 943.872 lekë, çka afekton analizën financiare të vitit 2007, duke çuar në një mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën -215.826 lekë.

25.14 Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se këto pamjaftueshmëri të konstatuara lidhur me kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi të pasurisë: “*Apartament banimi, me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>*”, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar parashikimet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr.84/2016, por në tërësinë e vlerësimit të fakteve të konstatuara dhe të trajtuara në këtë ankim, duhen vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji.

**26. Konstatime të tjera lidhur me Apartamentin 1+1, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Berat (në vijim, referuar si “Apartament Berat”)**

26.1 Në D-Vett., në rubrikën: “*Deklarimi i Pasurisë*”, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë përveç të tjerave edhe pasuritë e paluajtshme në përdorim, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar këtë pasuri, ndërsa në faqen nr. 4, ku kërkohet të deklarohen adresat e regjistrimit në gjendjen civile, si dhe adresa e plotë e banimit, subjekti i rivlerësimit, si adresë banimi, deklaron: Lagjja “\*\*\*\*”, Bashkia Berat.

26.2 Në DV-2012 deri DV-2018, subjekti i rivlerësimit si adresë banimi deklaron të njëjtën adresë: Lagjja “\*\*\*\*”, Bashkia Berat.

26.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në Pyetësorin nr.1<sup>58</sup>, për adresat ku ka banuar, ndër të tjera, përgjigjet se: [...]*Në muajin nëntor 2008 jam emëruar Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat. Në shtator 2012 kam tërhequr familjen nga Skrapari në Berat, ku kam banuar në një apartament 1+1, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 78.7 m<sup>2</sup> (sip. tot.) ZK \*\*\*, pronar i së cilës është Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësues ligjor \*\*\*, \*\*\*. Nga shtator 2012 deri në 31.12.2017, nuk kam pasur kontratë qiraje të formalizuar midis meje dhe kësaj shoqërie, por ka qenë kontratë verbale, në vlerën 5.000 (pesë mijë) lekë në muaj. Në datën \*\*.1.2018 kam formalizuar kontratën e qirasë me nr. \*\*\* rep., nr.\*\* kol., përpara noteres \*\*\*, \*\*\*. [...]*

26.4 Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 5<sup>59</sup>, ndër të tjera, shprehet se: [...]*Në apartamentin me nr. \*\*\*, me pronar “\*\*\*\* sh.p.k.”, \*\*\*, \*\*\*, kam banuar me qira deri në muajin maj 2021. Kontrata e qirasë me përfaqësuesin e “\*\*\*\* sh.p.k.”, \*\*\*, \*\*\*, është zgjidhur me mirëkuptim në datën \*\*.6.2021 [...]*

26.5 Në dosje të Komisionit, ndër të tjera, janë administruar aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si vijon:

(i) Kontratë qiraje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë \*\*.1.2018, me palë qiradhënëse shoqëria “\*\*\*\*.” sh.p.k., e përfaqësuar nga z. \*\*\*, \*\*\*, dhe palë qiramarrëse z. Pëllumb Zaimi, subjekti i

<sup>56</sup> Shihni f. 15-16, të vendimit.

<sup>57</sup> Referohuni Vendimit të Kolegjit nr. 18/2022 (JR), datë 8.6.2022, prg. 27.1.

<sup>58</sup> Përgjigjet e datës 22.1.2020, pyetja nr. 1.

<sup>59</sup> Përgjigjet e datës 7.7.2022, pyetja nr. 2.

rivlerësimit. Objekt kontrate është qiraja e apartamentit me sip.78.7m,<sup>2</sup> me afat 5-vjeçar, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, me masë qiraje 5.000 lekë në muaj.

(ii) Dokumenti me emërtimin “Vërtetim” i datës \*\*.6.2021, nënshkruar nga qiradhënësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuesi ligjor dhe ortak i vetëm i saj, z. \*\*\*\*.\*\*\*, ku thuhet se kontrata e qirasë, e datës \*\*.1.2018, është zgjidhur me mirëkuptim midis palëve, para afatit të saj në datën \*\*.5.2021.

(iii) Dokumenti me emërtimin “Formular i prezantimit të kërkesës ose ankesës”, me logo të Ujësjetllës-Kanalizime Berat-Kuçovë, me ekstremite seria:2021\*\*\*, nr.\*\*\* Regjistri, datë \*\*.6.2021, me ankimues Pëllumb Zaimi, me nr. dok. identifikimi \*\*\*, adresa lagjja “\*\*\*\*”, nr. kontrate \*\*\*, në objektin pallat. Në rubrikën: *Të tjera*, plotësuar me shenjë kutiza: “Mbyllje kontrate”, dhe në rubrikën *Shënime: Konsumatori kërkon mbylljen e kontratës sipas dokumenteve*.

(iv) Kopje e dokumentit “Mandatarkëtimi”, datë \*\*.6.2021, me nr. \*\*\*, arkëtuar nga z. Pëllumb Zaimi, shuma 1.200 lekë, për çregjistrim kontrate.

(v) Kopje e librezës së OSHEE-së, Berat, me numër kontrate \*\*\*, lëshuar për z. \*\*\*\*.\*\*\*, ku konstatohen pagesat për periudhën janar 2019 deri qershor 2021.

26.6 Komisioni nuk rezulton të jetë shprehur lidhur me rrethanat që rezultuan nga dokumentacioni i sipërcituar, në aktin: “Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi”, apo të ketë arsyetuar mbi to, në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2022, që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.

26.7 Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, për pasurinë “Apartament Berat”, e deklaruar si adresë banimi dhe e dokumentuar përmes marrëdhënies së qirasë nga familja Zaimi, për periudhën shtator 2012 deri në 31.5.2021, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., vlerëson se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, z. Zaimi, nuk gjejnë mbështetje në dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, i administruar në dosje të Komisionit, për sa vijon:

26.7.1 Referuar dokumentacionit: (i) Kontratë qiraje, datë \*\*.1.2018, si dhe (ii) Vërtetimit të datës \*\*.6.2021, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., rezulton se pronar i këtij apartamenti paraqitet shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ndërkohë që fotokopja e librezës për furnizimin me energji elektrike është në emër të shtetasit \*\*\*\*.\*\*\*. Sipas librezës në emër të shtetasit \*\*\*\*.\*\*\*, pagesat e energjisë elektrike fillojnë nga data \*\* janar 2019 deri më \*\*.6.2021<sup>60</sup>, periudhë që përkon me marrëdhënien e qiramarrjes për këtë banesë nga subjekti i rivlerësimit. Në dosje të Komisionit nuk gjendet i administruar dokumentacion lidhur me z. \*\*\*\*.\*\*\* apo marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me të.

26.7.2 Referuar dokumentit “Formular i prezantimit të kërkesës ose ankesës”, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Ankimuesit, ka plotësuar formularin për mbylljen e kontratës së furnizimit me ujë, administruar në zyrën e ankesave të Ujësjetllës-Kanalizime Berat-Kuçovë, në datën \*\*.6.2021, sipas të cilit konsumatori kërkon mbylljen e kontratës sipas dokumenteve. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009<sup>61</sup>, “Për miratimin e modelit të rregullores ‘Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a.’”, në pikën 2.9, Konsumatori dhe detyrimet e tij, paragrafi (2), përcaktohet se “furnizimi me ujë të pijshëm nga UK sh.a., për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë shtetërorë ose privatë bëhet në bazë të kontratave të shitjes (të furnizimit me ujë), që lidhen ndërmjet tyre. Kontratat për furnizimin me ujë, lidhen vetëm me pronarët e objekteve...”. Për sa i përket mbylljes së kontratës në të njëjtin vendim, në pikën 4.3., “Ndryshimi i abonentit”, paragrafi (1), përcaktohet se: “Në rastin kur një konsumator (pronari i vjetër) kalon të drejtën e tij të pronësisë tek një konsumator tjetër (pronari i ri), ai duhet të njoftojë me shkrim UK sh.a. për ndryshimin dhe të bëjë zgjidhjen e kontratës. Kontrata

<sup>60</sup> Sipas Vërtetimit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., marrëdhënia e qirasë ka përfunduar më \*\*.5.2021.

<sup>61</sup> Shihni Fletoren Zyrtare nr.198, dhjetor 2009.

*me pronarin e vjetër do të zgjidhet pasi ai të ketë paguar të gjitha detyrimet e konsumit të ujit deri në momentin e zgjidhjes së kontratës”. Po ashtu, referuar dokumentit: “Mandatarkëtimi”, është vetë subjekti i rivlerësimit, i cili, në datën \*\*.6.2021, ka kryer pagesë në funksion të çregjistrimit të kontratës së furnizimit me ujë.*

26.8 Sa më sipër, në kushtet kur: (i) deklarimi në Deklaratën “Vetting” për këtë pasuri në përdorim konstatohet i mangët; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë banuar në këtë apartament për rreth 10 vite; (iii) aktet e administruara lidhur me këtë pasuri janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, pas konstatimeve të Komisionit dhe në kushtet kur (iv) këto akte paraqesin të dhëna kontradiktore ndërmjet tyre, lidhur me të drejtat reale të pronësisë/posedimit, Komisioneri Publik vlerëson se ndodhemi në kushtet e pamundësisë objektive për të kontrolluar këtë pasuri dhe këto rrethana të padeklaruara nga subjekti dhe në Deklaratën “Vetting”, duhen analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera të këtij ankimi, në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

27. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

28. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

29. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

30. Bazuar në nenin Ç, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

31. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1,

germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 574, datë 18.10.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pëllumb Zaimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**